

Dr. sc. Nikë Gjeloshi

R E A G I M

SI DHE PSE FALCIFIKOHET HISTORIA?!

- autorit të librit „Republika e Parë-historia politike e Kosovës 1989-1999“ i kërkohet t`i përmirësojë të pavërtetat historike -

Kohë më parë me ra në dorë një publikim me titull „Republika e Parë-historia politike e Kosovës 1989-1999“, botim i UETPress, Tiranë, i autorit Mero Baze. Në atë publikim thëksohen të pavërteta që e dëmtojnë dedikimin, dëmtojnë protagonistë të kohës dhe falcifikojnë historinë e re politike të Kosovës.

1.Kapitulli i pestë „Qeveria e Përkohëshme dhe financimi i Republikës së Parë“, ka trajtuar: Qeveria e përkohëshme dhe financimi, Krijimi dhe funksionet e Qeverisë së përkohëshme, Fushata e parë e financimi 1989-1992. Gjithsej 7.5 faqe; për të kaluar në Skemat e financimit me përpjekjet e dështuara për bashkëpunim ushtarak me Shqipërinë dhe në Njesitë ushtarake të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të arritur te Dardania Bankë në Tiranë, e Kriza e përfolur rreth financimit të presidencës, etj.

Në fakt,

Shpallja e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut (1990) dhe e Kushtetutës me 7 shtator (1990) ishin vendime historike për Kosovën.

Shpërbërja me luftë e Federatës Jugosllave, fillimisht në Slloveni e Kroaci (qërshor 1991), i shpejtoi edhe synimet tona për shkëputjen de iure të Kosovës nga Serbia e Jugosllavia.

Kishte kohë që përmes një referendumi insistoja ta bënim atë shkëputje edhe Ne. Këtë formë shkëputjeje ua kisha garantuar edhe ca miqve perëndimor.

Shkëputja ndodhi: Referendumi u organizue nga 26-30 shtatori 1991, me tekstin për „Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur“!

Teksti i Referendumit të 26-30 shtatorit 1991 ishte hartuar nga Unë-autori i këtij reagimi-Nikë Gjeloshi, pa të cilin Referendum nuk do të mbështetej pavarësia e Kosovës. Këtë fakt historik, publikisht e theksoi Dr.Albert Rohan, zv/president i ambasadorit Martti Ahtisaarit (hartues i „Propozimit Gjithëperfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 26 mars 2007“), në tetor 2017, me rastin e paraqitjes së Problemit të Katalonisë për shkëputje nga Spanja, se: „... nuk

mund të bëhet krahasimi në mes Katalonisë e Kosovës, kjo sepse... , në shtator të vitit 1991 popullata shumicë shqiptare realizoi Referendumin e pavarësisë, me një pjesëmarrje prej 77% të popullatës, dhe me një votim pro pavarësisë prej 99 % të votuesve në referendum" (Dr.Albert Rohan, „Die Presse“, Wien (Austria) 9.10.2017).

Shqiptarët, përkundër rrezikut të dhunës, burgosjeve e vrasjeve që mund tua shkaktonte Serbia okupatore, nga 26-30 shtator 1991 e votuan Referendumin për shtetin sovran dhe të pavarur të Kosovës më tekstin që, Unë-Nikë Gjeloshi, e theksova dhe e imponova: E anulova Referendumin e 22 shtatorit 1991 qe e kishte tekstin konform nenit 2 të Kushtetutës së 7 shtatorit 1990, dhe Rezolutën e Vendimin e Kuvendit, të 22 shtatorit (1991), „Për Republikën e Kosovës..., me të drejtë të pjesëmarrjës konstitutive në lidhjen e shteteve-republikave sovrane (në Jugosllavi), mbi bazë të lirisë dhe barazisë se plotë të republikave-shteteve në lidhjen e tyre“ (shih: Akte të Kuvendit..., 98).

Po të mos ishte vendosmëria ime-N.Gjeloshi, për ta anuluar atë referendum të 22 shtatorit 1991 (tërhiqen Fletëvotimet e shpërndara në tërë vendin, tërhiqet gazeta 'Bujku', që e kishte publikuar në faqen e parë atë tekst të referendumit, kurse Komisioni i Referendumit mbetet i njëjtë), dhe për ta mbajtur katër ditë më vonë (shih, „Bujku“, 24 shtator 1991, 1), nga 26-30 shtator 1991

Referendumin me tekstin tim „për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur“, Kosova, pos me Kushtetutën e 7 shtatorit 1990 (Kaqanikut), edhe me Referendum do të mbetej në lidhje institucionale me federatën/konfederatën jugosllave, nën Jugosllavi, të cilën Slobodan Millosheviqi e krijoi në vitin 1992 (RFJ, Serbia e Mali i Zi).

Historikun e Referendumit „për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur“, e kanë ditë: Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, disa bashkëveprimtarë të mij e ma vonë edhe miq perëndimor që ishin njohtuar për Referendumin, edhe nga Unë, të cilët thonin se po mos ta kishit realizuar referendumin për pavarësi nuk do të merrej askush me Ju!

Historikun e Referendumit Unë e kam bërë publik, vitet: 1994, 1997, 2002, 2004, 2015, 2017 e 2023, në shkrime e libra të mijë, veçmas në librin „Ministria e mbrojtjes e Republikës së Kosovës 1991-1995“, Prishtinë 2015 dhe Zagreb 2017, i cili libër trajton ndërtimin e sistemit politik, të mbrojtjes e sigurisë brenda e jashtë vendit; me fakte, prova, dëshmi, shënime, biseda, njoftime, shkresa; dokumente hetuesie, prokurorie e vendime të gjykatave serbe, në Kosovë ..., ndaj grupeve të burgosurve shqiptarë të LKÇK, mbrojtjes e policisë; projekte të hartuara nga ushtarakë të karrierës, përfshirë projektin e kolonel Ahmet Krasniqit (prill 1993, dorëshkrimi origjinal gjindet tek Unë), të cilin, pas bisedës me mua-N.Gjeloshi (në shkurt të vitit 1992, në Zagreb) që ma kishte propozue Fehmi Lladrovci, e strukturoj në Ministri të Mbrojtjes; si dhe sfidat me të cilat është përballur veprimtaria jonë institucionale, e asaj periudhe. Libri ka pasur dy botime, dhe bashkë me libra tjera të mi gjendet në Arkiva e Biblioteka Kombëtare në Prishtinë, Tiranë, Shkodër e në disa Biblioteka Universitare të qyteteve perëndimore, si në Zürich, Gjenevë, Lausanne, Graz, Wien, München, Zagreb, Dubai, San Francisco, në Bibliotekën e Kongresit Amerikan në Washington D.C. etj.

Megjithatë, nga autori i publikimit „Republika e Parë...” e porositi, del se nuk e kanë rrespektuar të vertetën notore, e as nuk i kanë konsultuar ato publikime të mia, që janë bazë e historisë politike të Kosovës, veçmas libri „Ministria e mbrojtjes ...”, unike për temën që trajtohet dhe për një pjesë të periudhës e cila vetëm përmendet në atë publikim „Republika e Parë”.

2. Në trajtimin, „Krijimi dhe funksionet e Qeverisë së Përkohëshme” të „Republikës parë” (174, 175), dalin tri të pavërteta notore:

-E pa vërteta e parë ka të bëjë me gjaja se, “Qeveria e përkohëshme..., u prodhua nga aktet juridike të Kuvendit, i cili kishte miratuar rezolutën mbi shpalljen e Kosovës shtet të pavarur e sovran, me 22 shtator të vitit 1991”. E pa vërtetë sepse: Qeveria e përkohëshme që do të njifet si Qeveria e exilit prodhohet mbi baza të Referendumit të 26-30 shtatorit 1991, teksti i të cilit konform Amendamentit I në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e zëvendëson tekstin e mëparshëm të nenit 2 të Kushtetutës së 7 shtatorit 1990, në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës në exil, me 19 tetor 1991. Shih: Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 korrik 1990-2 maj 1992, ASHAK, Prishtinë 2005, 119 dhe në librin tim „Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës 1991-1995”, Botimi i dytë, Zagreb 2017, 48.:

të Republikës së Kosovës".⁷² Sipas pikës 6. b) Kuvendi kishte përcaktuar zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë së përkohshme të koalicionit të Republikës së Kosovës, kurse sipas pikës 7, ishte shqyrtuar propozimi për emërimin e ministrave përkatës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Akte, 2 korrik 1990 - 2 maj 1992. 119
 REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I REPUBLIKËS, Prishtinë, 19 tetor 1991

AMENDAMENTI I NË KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Teksti i nenit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës zëvendësohet me këtë tekst:
REPUBLIKA E KOSOVËS ËSHTË SHTET SOVRAN DHE I PAVARUR,
 (Shëfitor lidhur me tekstin e nenit 2 të mëparshëm fshihet).
 Alinën 2 e nenit 9 të Kushtetutës: "Shtetast e njësitve të gëra të Bashkësisë së Jugosllavisë gëzojnë lirinë dhe të drejtat e përcaktuara me aktin e saj", fshihet në tërësi.
 Në alinën 3, rreshti i dytë të nenit 56 fjalët: "Bashkësisë së Jugosllavisë e të", fshihen.
 Në alinën 1 pika 1 të nenit 97 të Kushtetutës fjalët: "si dhe jep përkrahimin e aktin me të lartë të Bashkësisë Jugosllave", fshihen.
 Neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fshihet në tërësi.
 Për zbatimin e këtij amendamenti në tekst Ligji Kushtetues.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

KK Nr. 21/91
 Prishtinë, 19 tetor 1991

Amendamenti I në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas të cilit, teksti i mëparshëm, i nenit 2 të Kushtetutës, zëvendësohet me këtë tekst: "Republika e Kosovës është shtet sovran dhe i pavarur", KK Nr. 21/91, Prishtinë 19 tetor 1991, Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës - 2 korrik 1990 - 2 maj 1992, ASHAK, Prishtinë 2005, 119 (Fjalja: Republika e Kosovës është shtet sovran dhe i pavarur e amenduar në Amendamentin I, është fjallë tekstualisht e bartur nga Refendumi i 26 - 30 shtatorit 1991, autor i të cilit tekst është autori i Librit).

⁷² Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 korrik 1990-2 maj 1992, ASHAK, Prishtinë, 2005, 140-144

- E pa vërteta e dytë del të jetë se, „Qeveria ka pasur dy nënkryetarë, Ramush Tahiri dhe Nikë Gjelloshi, si rekomandime të Këshillit Koordinues dhe pjesë e Partisë Shqiptare Demokristiane, të cilët iu bashkangjitën me vonë kabinetit. Detyra e tyre ishin të koordinonin organizmin e të rinjve që i iknin ushtrisë jugosllave në Kosovë dhe shkonin kryesisht në Shqipëri, si dhe të merreshin me

qështjet e mbrojtjes dhe sigurisë." Dhe,
- e pa vërteta e tretë, se „Mandati i tyre vazhdoi deri ne zgjedhjet e majit 1992“ („Republika e Parë“, 174, 175).

E verteta është se:

Ata dy qeveritarë ishin themelues dhe udhëheqjes të PSHDK: Ramushi sekretar, të cilin e kishte sjellë Nika në atë parti, kurse Nika nenkryetar qe i kishte dhanë emrin „shqiptare“, dmth.Parti shqiptare demokristiane e jo Pari Demokristiane siq insistohej, kohë të gjatë, nga disa nismetar.

Nika ishte hartues i dokumenteve bazë e i Programit të asaj Partie per çfar pos qe nuk regjistrohet ajo Parti sipas Ligjit jugosllav, Nika, si hartues e nenshkruer i dokumenteve bazë të Partisë, procesuhet per tre vepra penale: a)për nocionin komb, b)shtrirjen organizative të Partisë edhe jashtë Kosovës, dhe c)bashkim kombëtar. (Nocioni i bashkimit kombëtar do të hiqet nga Programi i asaj Partie kater vite më vonë, në vitin 1994, nga drejtuesi i asajë Partie-lauerat i Medaljës se Artë të Jugosllavisë vitin 1965 per kontribute të veqanta...(!). Dhe per shkak te heqjes se bashkimit kombëtar nga Programi do të ketë kundershime e reagime publike të Degëve të PSHDK, por edhe përjashtime jashtstatutare të shumicës se degëve në Deqan e Klinë; pas disa ditëve edhe burgosje të disa drejtuesve të Degës së Deqanit, si historianin Selim Lokaj etj.).

As Nika as Ramushi nuk ishin pjesë e asaj Partie në Qeveri, sepse ajo Parti nuk kishte propozuar emra për anëtar Qeverie të Përkohëshme/exilit. Ata dy qeveritarë ishin propozue nga Këshilli Koordinues i Partive politike, gja qe ishin dakordue edhe vet me propozimin, kurse Kuvendi (në exil, në Slloveni) ka bërë zgjedhjen formale, si për Qeverinë e exilit në tërësi ashtu edhe për çështje tjera...

Ata dy nënkryetarë ishin edhe ministra të asaj qeverie, por ato poste nuk qenë bërë publike per çështje sigurie, për çfarë ishin emërue si NN ministra: Tahiri, i cili kishte dalë jasht Kosovës kur edhe Bukoshi, ishte-NN Minister Republikan i Punëve të Brendshme (Vendimi, KK Nr.34/91, Prishtinë, 19 tetor 1991, Akte të Kuvendit..., Prishtinë 2005, 133), të cilin, per çeshtje të mbrojtjes, e kishte autorizuar Gjeloshi, deri të arrinte edhe ai vet, qe t'i kontaktonte oficerët shqiptarë në Sloveni e Kroaci qe e kishin braktisë Armaten Jugosllave; kurse Gjeloshi-NN Minister Republikan i Mbrojtjes (Vendimi, KK Nr.33/91, Prishtinë, 19 tetor 1991, Akte të Kuvendit ..., Prishtinë 2005, 132), gjë që nuk theksohet në atë publikim „Republika e parë“. Edhe kur ishte zgjedhë Qeveria e Përkohëshme e Koalicionit/exilit, me 19 tetor 1991, e propozuar nga Këshilli Koordinier, Bukoshi vetem i ka paraqitë perbërbjen dhe emrat e anëtarve të Qeverisë në atë seancë të Kuvendit, në Slloveni. Aq ka qenë roli i tij!

Gjeloshi, derisa kishte siguruar pasaportë udhëtimi për familjen (bashkëshorten e 6 fëmijë të mitur), kishte ardhur disa javë më vonë në Bled (Slloveni), ku ishte vendosur Qeveria e exilit (në Vila e Akademisë së Shkencave e Sllovenisë; ishin akomoduar katër ministra plus kryeministri në Bled e Ulm!). Aty, Gjeloshit: a)i improvizohet Dhoma e fjetjës në Tavan të atij Objekti, e qe Bekim Berisha-Abe që gjendej në frontin e luftës në Kroaci, pasi degjon per ate improvizim, kërkon nga Unë ta lejoj t'i ndeshkon ata qeveritarë, b)nuk i sigurohen financat për

familje, siç ishte marrëveshja, si për familjen e Bukoshit e tjerëve, c) atyre qeveritarëve sapo u janë dorëzuar paratë e „Fondit gjithkombëtar“ (Fondi 1000, nga Degët e LDK etj, në Zvicër e Gjermani) ato para i kishin ndarë mes vete dhe kishin treguar natyrë lakmitare, si ves më i keq gjatë historisë së krijimit të shteteve, d) në frontin e luftës në Kroaci po vlonin konfliktet nëmes disa oficerëve e ushtarëve shqiptar të shitur për të luftuar ... Kështu, Gjeloshi vëhet mes dilemave: Të tërhiqet nga postet nga një qeveri e pa përgjegjëshme, që sapo kishte filluar mandatin, apo t'i përbinte edhe ato sfida dhe ta vazhdonte veprimtarinë për të mirën e popullit e vendit? Vendosë ta vazhdon veprimtarinë; i qetëson konfliktet e ushtarëve shqiptarë, u siguron atyre letra udhëtimi, për në Evropë, nga organet përgjegjëse kroate (me ndermjetësimin e Nenkryetarit të Republikës së Kroacisë, profesorit-dekanit e mentorit të tij-N.Gjeloshit; perderisa ata oficerë që i kishin shitë ata ushtarë, kush e kishte braktisë frontin e luftës më parë ishte dëtyruar të paguaj shumë marka gjermane për një Dokument udhëtimi për në Evropë, gja që disponoj më qindra deklarata...). Ma në fund Gjeloshi e organizon edhe financimin e familjes së vet përmes të afërmeve e ndihmave të shtetasve austriakë të lokalitetit ku e vendosë familjen. Çështjen e financimit të Familjes, i cili financim i që kushtëzuar me „...heqjen dorë nga Rugova“, Gjeloshi e kishte bisedue edhe me Rugovën, që ai financim të bëhej edhe përmes „Fondit të Aachenit“ - "Fondi humanitar për Kosovën" (Gjermani), si fond i veçantë, por perkunder dakordimit nuk u realizue asnjëherë. Për atë formë financimi të kërkuar ishte në dijeni edhe udhëheqësi i atij „Fondi“, Marjan Tunaj (tashmë i ndjerë), i cili, me kërkesën e Gjeloshit i kishte derguar edhe materiale për funksionimin e atij Fondi.

-E pavërteta e tretë, që theksohet në publikimin „Republika e Parë“, se çështja e mandatit të tyre „... vazhdoi deri në zgjedhjet e majit 1992“, del të jetë manipulim dhe gënjeshtër ordinere.

Mandati deri në zgjedhjet e majit 1992 ka mundë të bëjë me Ramush Tahirin, i cili, pas atyre zgjedhjeve të majit 1992, shkarkohet nga pozitat në Qeverinë e exilit, përkatësisht „lirohet“ nga ato pozita, dhe atë mbledhje e ka udhëheqë vet Bujar Bukoshi. Lirohet, sipas propozimit të Gjeloshit: „Jo të shkarkohet, të lirohet!“ Shkarkimin e kërkonte një anëtar qeverie aty, në prezencën e Tahirit, por Gjeloshi si një idealist e humanist e thekson idenë „lirim“ edhe se nuk ishte kategori kushtetuese, ashtu që Tahiri „lirohet“ nga Qeveria e përkohëshme, për çfarë ishte dakordue edhe presidenti Rugova. Sigurisht se Bukoshit (sado i sëmurë tash e sa vite), por edhe anëtarëve tjerë të Qeverisë (ende jetojnë), u kujtohet çfarë tha Gjeloshi në atë mbledhje të Qeverisë?!

Edhe për zgjedhjet e 24 maj 1992, Gjeloshi e kishte bërë zgjidhjen Kushtetuese për t'u mbajtë ato, të cilën zgjidhje nuk e kishte bërë Akademia e Shkencave e Arteve të Kosovës (ASHAK). Për atë zgjidhje i falënderohet Rugova, dhe shumë tjerë. Për ma tepër, as Qeveria e Përkohëshme e koalicionit e njohur në popull si Qeveria e exilit, pa Gjeloshin nuk do të bëhej, gja që e kushtëzonin Rugova e anëtarë të Këshillit Koordinues të Partive Politike. Sëpse Gjeloshi ishte:

a) protagonist i mbrojtjes së subjektivitetit të Kosovës, vitet 1988/89/90, dhe kishte bërë shumë veprime historike për ta mbrojtë atë subjektivitet,

b)themelues i Këshillit Koordinues të pesë (5) Partive politike shqiptare në Kosovë (me insistimin e votën e tij-Gjeloshi, Ibrahim Rugova zgjedhet kryetar i atij Këshilli përkundër mospajtimit të dy anëtarëve të atij Këshilli), c) themelues i Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi (11 parti bashkë me të Kosovës, dy prej të cilave nuk marrin pjesë as nuk nenshkruhen) dhe hartues e nënshkruar i atij Vendimi 28 gusht 1991 (Shih: librin tim „Kosova në Udhëkryq 89-humbja e subjektivitetit dhe përpjekjet për pavarësi-“, (BG) „Velar“, Itali 1997, 148; dok.origjinal në arkivin privat), d)hartues i Platformes Politike të tre Opcioneve (shih: librin tim „Kosova në Udhëkryq 89...“, 149; dok.origjinal në arkivin privat), e)autor i tekstit të Referendumit të 26-30 shtatorit 1991 „Per Kosovën shtet sovran e i pavarur“ (shih: librin tim „Kosova në Udhëkryq ,89...“, 143, 144,145; dok.origjinal në arkivin privat), f)ideator i formimit të institucioneve shtetore, perfshi Ministrinë e Brendëshme nga Sindikata e policisë (shih: librin tim „Ministria e mbrojtjes...“, 83, fuss 119), dhe i Ministrisë se Mbrojtjes, për të cilat ministri kishte hamendësime të mos formohëshin fare(!); g)në deklarime publike dhe ndër miq perëndimorë, me argumentimin e lidhjeve të gjakut, gjuhës e traditës më të forta se të fesë ndër shqiptarë, e kishte thartue tezën e Sllobodan Millosheviqit se „...shqiptarët janë fundamentalistë islamik“, gj)kishte krijuar miqësi me disa shtete perëndimore, të cilat bëhen mbështetës kryesor të pavarësisë së Kosovës.

Shkurt: Gjeloshi ishte themelues i Shtetit të Kosovës, e kishte shpëtuar Republikën, kishte krijuar miqësi në Perëndim dhe përmes Tij mbështetët Pavarësia e Kosovës!

Për historinë politike, e theksoj se Akademia e Shkencave e Arteve e Kosovës (ASHAK) kishte rekomanduar se: „Nuk mund të shpallen zgjedhjet parlamentare e presidenciale, mbase Kushtetuta e 7 shtatorit 1990 e ka përcaktue Kryesinë si organin kolektiv më të lartë të Kosovës. Per t'i ndryshue kompetencat Kushtetuese të Kryesisë se Kosovës, si Organ kolektiv, duhej mbaj të Referendum,- Referendum nuk lejon Millosheviqi, zgjedhjet nuk mbahen!“ Unë-N.Gjeloshi e zbuloj zgjidhjen: „Më Amendament kompetencat kushtetuese të Kryesisë së Kosovës (nenet 107,... 111) t'i barten Kryetarit të Republikës“! Sipas asaj zgjidhje nga Unë shpallën e mbahën zgjedhjet e 24 majit 1992 për kryetar dhe delegatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Pa atë zgjidhje kushtetuese Kosova do të mbetej pa institucione të veta shtetërore, edhe se nën okupim nga Serbia, dhe nuk do të mbante zgjedhje për Kryetar/President e as për Parlament.

Me atë zgjidhje kushtetuese nga Unë-Nikë Gjeloshi, Kosova bëhet me President historik! President historik zgjedhet Dr.Ibrahim Rugova!

3.Kryetari i Qeverisë se exilit, Bujar Bukoshi, në fund të dhjetorit 1992, një grupi të mbrojtjes qe e kishte takue në Tiranë, i kishte dhënë urdhërit „T'i futet fitili Gjakovës“, pa konsultë me Presidentin Ibrahim Rugovën, e as me Ministrin e Mbrojtjes Nikë Gjeloshin. „Futja e fitilit“ do të merrej si shkas qe forcat okupuese ushtarake Serbe të vritnin e masakronin mijëra Shqiptarë, e ta rrafshonin tërë Qytetin (ajo që me vonë do të njifej si 'Plani Patkoi)', por ate urdhër e pengon Gjeloshi mbase, nga Sali Çekaj njohtohet në Stuttgart, në

mesnatë (ishte aty edhe Gjeloşi) dhe, për telefon bisedon me të organizuarit për mbrojtje në Gjakovë të cilëve u urdhëron „Rubikoni nuk kapërcehet. Për zjarr duhet përgatitje dhe në të njëjten kohë duhet përfshirë e tërë Kosova!“ Urdhëri rreshpektohet. Sapo e kryen atë bisedë Gjeloşi i telefonon edhe Bukoshit (në Ulm), i cili fillimisht nuk e pranon së ka dhanë urdhër „t’i futet fitili Gjakovës“, por gjatë bisedës pohon së „nuk do të vepron ashtu ma“ (shih: librat e mi „Kosëva 99...“, 56 dhe „Ministria e mbrojtjes...“, 82, fuss 114).

Në takimin e parë e njohtoj edhe Rugovën, për çfarë ishte vue në dijeni, dhe falenderohet! Për atë rast do njohtohet edhe këshilltari i Gjeloshit, Gjeneral Kolonel Ramiz Abdylit, në një takim në München, ku do jetë edhe Bukoşi (Abdylit i lindur në Pejë, më karrierë të gjatë ushtarake; ato vite ishte edhe bashkëpunëtor i jashtëm i „Qendrës për Hulumtime Strategjike“ të Ministrisë së mbrojtjes së Republikës së Kroacisë, në Zagreb, ku edhe jetonte). Për angazhimin e Gjeneral Avdyllit, si këshilltar i Ministrit të mbrojtjes-Nikë Gjeloshit, i cili ishte i dakorduar me Strategjinë e mbrojtjes të percaktuar nga Gjeloşi, shih shkrimin e autorit të Reagimit-Gjeloshit „E Vërteta është vetëm një“, ndaj shkrimit të Kolonel Hajzer Hajzerajt „Perpjekjet për organizimin e strukturës së mbrojtjes“ (‘Bota sot’, 1-5 Mars 2001), i cili-Hajzerajt, jo se nuk e kundërshton asnjë fjalë, por, si njëri i ndërgjegjshëm e i përgjegjshëm, e ndërprente rrefimin e Tij të mëtejme për organizimin e Mbrojtjes! (Shih, Nikë Gjeloşi, „E Vërteta është vetëm një“, Bota sot, 26 Mars 2001,4).

Në dhjetor 1992 e maj 1993, Unë-Nikë Gjeloşi, do i dorëzoj Bujar Bukoshit 72 Elaborate të hartuara nga ca oficerë karriere e Unë (me listë, numër faqesh e nënshkrim), ndër ato edhe Elaboratin për Aeroportin e Sllatinës, për t’i shërbye organizimit të mbrojtjes në Kosovë, mbase Bukoşi udhëtonte më shpesh nga Gjermania për në Tiranë dhe kishte marrë obligim t’i percjellë ato elaborate për në Prishtinë (shih, në librin tim „Ministria e Mbrojtjes...“, 60, 61, 62 e fuss 86).

4.Gjeloşi qeshtjën e mandatit në Qeverinë e exilit do ta bisedon me Presidentin Ibrahim Rugovë në Tiranë, me 24 prill 1993, dhe, pas një bisede të gjatë me Te, e paralajmëron: Po u pengova edhe mëtej për ta strukturuar Ministrinë e Mbrojtjes (brenda e jashtë vendit), dhe poqese në strukturën udhëheqese nuk vëhen gjërat mbi baza Kushtetuese, Unë do të tërhiqem nga Qeveria. Rugovë i kishte dhanë fjalën Gjeloshit së „do t’i regullon këto probleme“, për të cilat probleme i kishte njoftuar edhe ca bashkëpunëtorë të vet (shih, në librin tim „Kosova 99-as republikë e proklamuar as autonomi e imponuar“, EBP „Gjergj Fishta“, Ribotim,Tiranë 2004, 55-68).

Arsyet tjera që Gjeloşi e paralajmëronte dorëheqjen, për çfarë e kishte bërë me dije edhe Bukoşin, ishin: menaxhimi i keq i Qeverisë, pengimi i funksionalizimit të Ministrisë së Mbrojtjes e mosfinancimi i asaj Ministrie e i Ministrit; pamundësia që të merr përgjegjësi për vendimet që merren pa konsultime, mbase pushteti po ndërtohej pa kontrollë e pa përgjegjësi nga vet kreu i institucioneve; moszbatimi i Kushtetutës, moskonstituimi i Parlamentit e moszgjedhja/ëmrimi i një qeverie të re, pas Zgjedhjeve Parlamentare e Presidenciale të 24 majit 1992. Të gjitha këto ishin indikatorë së ideja e pavarësisë dhe shtetit të Kosovës po shkrihej që në nismë.

Ato papërgjegjësi nuk kanë mundë të bëhëshin të njohura për publikun ashtuqë okupuesi-Serbija t'i dinte degradimet tona institucionale të shtetit të shpallur të Kosovës.

Pos asaj bisede me 24 prill (1993) në Tiranë, aty, kam bisedë me Rugovën edhe me 25 e 26 prill 1993 (me 25 prill Papa Gjon Pali II viziton Shqipërinë. Në pritje në 'Rinas' ishim edhe Ne si delegacion i Kosovës, dhe ajo vizitë e Papës vlerësohet historike për të gjithë shqiptarët). Kurse me 12 qershor 1993, në Ulm (Gjermani), kam takim më Bujar Bukoshin e Hajzer Hajzerajn (pas tre ditë të takimit të Hajzerajt më Bukoshin, Isa Mustafën e personin NN, sipas deklaratës se Hajzerajt që me bënë, edhe se takimin me Hajzerajn e kisha kerkue Unë, për ta emëruar në krye të Shtabit, pa prezencën e dikujt tjetër, pos eventualisht me prezencën e Bukoshit si kryeminister). Mbase Hajzeraj fillon të shpjegon se çfarë është punë për mbrojtjen neper komuna të Kosovës, Unë e ndërprej me arsyetim se s'ka nevojë të folen detajet, Hajzeraj pergjigjet „Te gjitha detajet i kam folë para këtyre që tre ditë...“! Pas atij takimi Hajzerajt i jap disa elabore që t'u shërbejnë për nevojat e mbrojtjes... (shih në librin tim „Kosova 99..., 55-62“).

Me 21 qershor 1993 serisht takohem me presidentin Rugova në Krans Montana (Zvicër), për të njëjtat probleme, kurse me 22-24 shtator 1993 kemi takimin e Qeverisë së exilit në Tiranë, përmbajtja e të cilave takime gjëndet në shkrime e libra të mij, si në „Kosova 99...“, e në „Ministria e mbrojtjes...“. Takim me Rugovën do të kam edhe më 5 dhjetor 1993, në Wiena të Austrisë (shih në librin tim „Kosova 99..., 60“).

Në vazhdim:

- Foto e tekst, me 10 tetor 1992, në Stuttgart, ku janë bashkë Rugova, Bukoshi e Gjeloshi.
- Foto e tekst me presidentin Sali Berisha nga një takim me bashkëkombas, në München me 15 nëntor 1992.
- Foto e tekst, me 28 nëntor 1992 në Tiranë, me rastin e festës së Flamurit.
- Shkresë e LPRK dorëzuar nenkryetarit të Qeverisë, Nikë Gjeloshit, në Zürich me 6.04.1993, mbase postin e ministrit të mbrojtjes nuk e theksonim me shkrim.
- Një Intervistë dhënë një gazete në maj 1993, në Wiena dhe
- Një ekstrat nga Procesverbali i mbledhjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në exil, me 25.06.1993, në Stuttgart, që të gjitha këto pas zgjedhjeve të 24 majit 1992!

Deshmi:

- Foto me 10.10.1992: Rugova, Bukoshi e Gjeloshi, bashkë me tekstin e publikuar në librin tim „Ministria e mbrojtjes ...“, 85.

detaje edhe lidhur me takimet dhe mbështetjet nga Austria, Gjermania, Vatikani. Do të njohtohet edhe për porosi të interesit me të lartë shtetëror..., e cila më ishte përcjellë mua personalisht.¹²³



Gjermani, Stuttgart, Hotel "Interkontiental", 10.10.1992

Në mes: Presidenti Ibrahim Rugova, në të majtë të tij: kryetari i qeverisë Bujar Bukoshi, kurse në të djathtë: nënkryetari i qeverisë e ministër i mbrojtjes Nikë Gjeloshi. Pasi Rugova ka vërejtur mbi supet e Nikës, Nika thotë "Ta trashim miqësinë" dhe shpërthejnë të qeshurat, ashtu sikur vërehen në fotografi.

Presidenti Rugova, gjatë asaj bisede, do të sygjerohet të mos bëhen kontakte zyrtare me shtetet islamike për shkak të ndikimit eventual të islamizmit në Kosovë, i cili ndikim do të verifikonte tezën e Serbisë për 'fundamentalizmin islamik'. Kontaktet eventuale me ato shtete, i kisha theksuar, do të ndikonin në mbështetjen e çështjes së Kosovës nga Perëndimi gjë që vërehej antidisponimi mu nga ky shkak.¹²⁴ Rugova do të dakordohet me pikëpamjet dhe sygjerimet e mia të theksuara, dhe do të pohojë: "Kam patur oferta për biseda me shtetet arabe, por i kam refuzuar shkuarjet, pos Turqisë". Dhe, në Konferencën e shtypit, më 23 maj 1992, në prag të zgjedhjeve parlamentare e presidenciale, Rugova kishte dhënë qëndrimin e tij lidhur me kontaktet eventuale me shtetet

¹²³ Bisedë e nënkryetarit të qeverisë dhe ministrit të mbrojtjes Nikë Gjeloshit me presidentin e Republikës së Kosovës Ibrahim Rugova, bërë në Hotelin "Interkontinental" në Stuttgart, 10.10.1992.

¹²⁴ Po aty



- Foto nga një takim me biznesmenë shqiptarë të Gjermanisë, në Hotel Internacional, në München, me 15 nëntor 1992: Presidenti Sali Berisha, dukefolur. Në të djathtë të Tij, Bukoshi me bashkëshorten; në të majtë Gjon Berisha(biznismen nga Hamburgu), Nikë Gjeloshi, ambasadori Xhezair Zaganjori (shifetfare pak) dhe dhjetra shqiptarë që nuk shifen në foto, por që ka video të atijtakimi.



Tiranë, 28 nëntor 1992 me rastin e kremtimit të Festës së Flamurit


Në pritje festive të presidenti Sali Berisha: në të djathtë të Berishës, presidenti Ibrahim Rugova, kryetari i PD-së Eduard Selami, përfaqësuesi i Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë Christopher Hill, Ali Spahia deputet i Kuvendit popullor, Anton Qetta pajtuesi i gjaqeve vitin 1990, nënkryetari i qeverisë dhe ministër i mbrojtjes Nikë Gjeloshi. Në të majtë të Berishës, këshilltari i Rugovës, Avni Spahiu

Shqipëria do të jetë vendi i parë jashtë Aleancës Veriatlantike – NATO, me të cilën kjo e dyta kishte fillua bashkëpunimin. Në këtë kuptim, një delegacion i NATO-s do të vizitojë Tiranën, përkatësisht Akademinë Ushtarake Shqiptare, dhe më 4 shkurt 1993 kishte përcjellë një stërvitje ushtarake në Tiranë. Ushtrimet ushtarake ishin përcjellë dhe nga ushtarakë të lartë, nga: Turqia, Bullgaria, Italia, Greqia, SHBA-të. Të njëjtën ditë të arritjes së delegacionit të NATO-s në Tiranë, anijet e luftës së NATO-s ishin vendosur në Adriatik, me qëllim të kontrollit për të zbatuar Embargon të cilën OKB e kishte vendosur ndaj RFJ-së (Serbisë e Malit të Zi). Ishte ky koncentrimi më i madh i forcës ushtarake – NATO në Adriatik që nga Lufta e Dytë Botërore. Ky koncentrim luftarak përbëhej nga: 3 aeroplanmbajtës "John Kennedy" nga SHBA-të, Ark Royal nga Anglia, Clemanceau nga Franca. Një helikoptermbajtës nga Guam i SHBA-ve. Anije luftarake: SHBA-të 11 anije, Franca 8, Anglia 6. Po atë ditë të ushtrimeve anijet kontrolluese të NATO-s bllokojnë anijen kroate "Vela Lluka" me 185 tonë eksploziv TNT, i cili përdorej për mbushje të minave dhe raketave kundërtank. Anija, pronë e Companisë së anijeve të Dubrovnikut, ishte ankorua në Portin e Barit të Italisë. Sipas pohimeve të kapitenit dhe dokumenteve që posedoheshin, ajo anije ishte ngarkuar në portin e Durrësit, dhe eksplozivi transportohej për nevojat e industrisë, ndërsa destinacion kishte Triestën, gjë që ishte mohuar. Ditë më vonë në kufirin shqiptaro - malazez

-Foto në Pallatin e Brigadave në Tiranë, me rastin e kremtimit të festes së Flamurit, me 28 nëntor 1992, bashkë me emrat e të pranishmëve me tekstin e publikuar në librin tim „Ministria e mbrojtjes...“, 88.

-Në sajë të dakordimit edhe me Gjeloshin, si nënkryetar i qeverisë dhe ministër i mbrojtjes, LPRK ishte vënë në dispozicion të Qeverisë së exilit, dhe i ngarkuari i

LPRK, Fazli Veliu, ia dorëzon shkresën me listen e 30 personave nenkryetarit të Qeverisë, Nikë Gjeloshit, i cili ata persona i sistemon në strukturën e Ministrisë së mbrojtjes (shih shkresën, Zürich me 6.04.1993, e cila në faqen dy i ka edhe emrat e atyre 30 personave).



-Pas një takimi me përfaqësues të partive politike e shoqatave shqiptare në Vjenë (maj 1993), jap një intervistë në të cilën, pos domosdosë se konstituimit të Parlamentit dhe zgjedhjes së Qeverisë së re, theksoj: „... Ne nuk ushtrojmë iluzione se çdo gjë do të vijë nga faktori i jashtëm. Populli shqiptar do ta realizojë gjithsesi sovranitetin e vet dhe do të bëhet subjekt ndërkombëtar... Pushteti serb të terhiqet me të gjithë instrumentet e tija nga Kosova, dhe meqë me 8 prill 1993 RJ e Maqedonisë që pranuar në OKB, shqiptarët duhet të jenë

popull shtetformues me të gjitha të drejtat, kompetencat e përgjegjësitë për ndërtimin e atij shteti të ri" (shih, Intervista me nënkryetarin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nikë Gjeloši, „Pasqyra“, gazetë mujore politike, kulturore e shkencore, Wiena, Maj 1993, Nr.3, 7,8).

Tërheqjen e pushtetit okupues të Serbisë nga Kosova dhe zgjidhjen e qashtjes së Kosovës, edhe sipas modelit të RJ të Maqedonisë, e kisha kërkuar nga disa miq; i kisha dërguar shkresë Nënë Terezës në Romë (e cila gjendej aty për shërim), që „... të ndikojë tek Ati i Shejtë Papa Gjon Pali II, si dhe tek autoritetet botërore në pengimin e luftës në Kosovë..., dhe të mbështetet rruga jonë e drejtë për paqe, liri e vetvëndosje" (shih, në librin tim „Kosova 99...“, 75). Kurse, tek disa autoritete përëndimor kisha këkuar intervenimin e NATO-s ndaj Serbisë (sulme ajrore ndaj bazave ushtarake e fabrikave të armatimit të ish-Jugosllavisë, në Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi); qe pothuaj në të njëjten kohë intervenimin e NATO-s nga ajri del ta ketë kërkuar edhe presidenti kroat Dr.Franjo Tuxhman, që e publikon Wikiliks 19 vjet më vonë (shih në librin tim „Ministria e mbrojtjes..., Zagreb“, 2017, 92 e fus 136 dhe 93).

-Ekstrat nga mbledha e Qeverisë së exilit në Stuttgart me tekstin e publikuar në librin tim „Ministria e mbrojtjes ...“, 97.

EKSTRAKT

nga procesverball i mbledhjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbajtur më 25.06. 1993

Mbledhjen e Qeverisë e udhëhoqi kryetari, dr. Bujar Bukoshi.

Në mbledhje ishin të pranishëm: prof. dr. Muhamet Bicaj, mr. Isa Mustafa, Mr Nikë Gjeloşi, Xhafer Shatri dhe Halit Muharremi.

Me propozimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Qeverisë, në mbledhje u shqyrtua ky :

REND DITE

1. Pozita e shqiptarëve nga Kosova në shtetet perendimore dhe problemet e tyre me dokumentet e udhëtimit;
2. Informata lidhur me përfundimin e vitit shkollor në shkollat private në Kosovë dhe përgatitjet për vitin shkollor 1993/94.
3. Informatë lidhur me ecurinë e ndihmave nga bashkatdhetarët tanë në diasporë për Republikën e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Rendit të ditës konkludoi si vijon:

Ekstrat nga mbledhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Stuttgart, 25 qershor 1993

Në Pejë, më 9 korrik 1993, 25 policë do të bastisin shtëpitë e vëllezërve të nënkryetarit të qeverisë dhe ministrit të mbrojtjes, në kërkim të armatimit për luftë... Tre (3) ditë më vonë (11.07.93), përmes korrespondentit të radio Tiranës në Vjenë, Rifat Buzukut, unë jap një intervistë për atë radio, sipas së cilës do të theksoj: "... dhuna dhe terrori i regjimit serb të Sllobodan Millosheviqit ndaj popullit shqiptar në Kosovë, vazhdimisht po shtohet... Qarqet militante serbe po vazhdojnë represionin me qëllim që të shtojnë trusni në popull dhe të përgatisin opinionin e vet për konflikt të armatosur dhe frikësimin e shqiptarëve për të lëshuar vatrat shekullore, por këtë s'do ta arrijnë... Të afërmit e mi dhe populli do të qëndrojnë në troje të veta, pavarësisht represioneve serbe..."! Kurse, më 13 korrik, po në radio Tirana, nga një konferencë shtypi e PSHDK-së (Partia shqiptare demokristiane, njëri nga themeluesit e asaj partie isha unë - Nika, dhe i kisha dhënë edhe emrin shqiptarë), theksohej nga zëdhënësi i asaj partie: "Me deklarata pompoze të nënkryetarit të qeverisë në ekzil, nuk rregullohet puna, por me punë në Kosovë".¹⁴⁴

¹⁴⁴

Radio Tirana, 14.07.1993

Këshilli koordinues i PSHDK, në reagimin e tij me 24 korrik 1993, theksonte: "... E konsiderojmë të pabazë, qëllimkeqe, njollosese konstatimin e Kryesisë së PSHDK, së Nikë Gjeloşi nuk mund të flas e as të perfaqësoj PSHDK-në. Këshilli koordinues i PSHDK perkahë në tërësi dhe plotësisht intervistën e Nikë Gjeloshit dhënë Radio Tiranës, i cili është anëtar meritor i kësaj partie, por edhe nënkryetar i qeverisë së

Këto dëshmi e fakte, dhe tjera, që gjenden edhe në publikimet e mija, si studime empirike të të verejturit sistematik të fenomeneve politike të periudhes së trajtuar, bazuar edhe në pervojën time si protagonist, që paraqesin bazën e historisë politike të Kosovës, është dashur ta frenojnë gënjeshtren e tipologjisë Staliniste të prezentuar në atë publikim „Republika e parë“, 174, 175.

5. Gjeloshi, qe nga mbajtja e atyre zgjedhjeve të majit 1992, i kishte kërkuar Rugovës që, sipas kompetencave Kushtetuese, duhej të Konstituohej Parlamenti (qoftë edhe përmes improvizimit me disa deputet me foto, në selinë e LDK-Shoqatën e shkrimtarëve), të zgjedhet ose konform Amandamentit IV të Kushtetutës të emrohet qeveria e re.

Qeveria, kisha theksuar: duhet të jetë legjitime e të funksionalizohet, edhe nga shkakut se miqtë tanë mbështetës po hezitonin në legjitimitetin tonë, dhe së fundi mosveprimi i Qeverisë sipas Kushtetutës, na e pamundëson qëllimin përfundimtar, pavarësinë e sovranitetin e Kosovës.

Gjeloshi, si nënkryetar i Qeverisë-zv/kryeminister e ministër i mbrojtjes i Republikës së Kosovës, edhe me 12 e 14 prill 1995 në Durrës (Rezidenca e Delegacioneve) e Tiranë (Vila 31), e së fundi me 5 maj 1995 (Vila 31, në Tiranë), i shoqëruar nga disa oficerë të strukturuar në Ministrinë e mbrojtjes, me të cilët kishte udhëtuar nga Zvicra (via Zürich-Wiena-Lubjana-Tirana) dhe, me disa të sistemit të sigurisë së Mbrojtjes nga Kosova, si me Ramë Maraj e ca tjerë (të arratisur; Maraj me jep edhe shkresa për sektorin e Mbrojtjes të cilat ia kishte dhanë edhe presidentit Rugova), kam bisedë të gjatë me presidentin Ibrahim Rugova. Rugova „me kishte kërkuar falje se është sjellë keq ndaj meje-Nikës, se jam penguar në kryerjen e funksionit, se me kanë takuar kushtet për mbajtjen e familjes, se...“, dhe ishte zotuar: „Nikë, për 10 ditë do ta kryej këtë punë. Kam dashtë këtu ta publikoj përbërjen e qeverisë, por e kam lanë pasi të kthehem në Kosovë... Mos ke punë me Bujarin. Me Bujarin do ta kryej definitivisht për 10 ditë. Ti je autoriteti i kombit dhe i shtetit, Nikë. Unë do t'i mbaj fjalët“. Me Rugovën kisha biseduar edhe për dy gjëra historike të interesit kombëtar, që mund të arrihen njëherë në Një Shekull, e që ishin ide e kërkësa të mia, për të cilat me ishte dhanë mbështetje nga miq perendimor dhe mund ta njoftoja vetëm Rugovën, të cilit i besoja! Në fund, i kisha komunikue: Nëse edhe më tutje nuk zgjedhet apo emrohet qeveria e re, pavarësisht përbamjes së saj, Unë dorëhiqem, dhe, mbase nuk mund të kthehem në Kosovë, do e vazhdoj veprimtarinë time me miq që na mbështesin, dhe me të gjithë ata bashkëveprimtarë që kanë qëllim pavarësinë e popullit e vendit-Kosovës. (shih në librat e mijë, „Kosova 99...“, 55-62, e „Ministria e mbrojtjes...“, 14,149). As pas asaj bisede e zotimi Rugova nuk emëroj qeveri të re, konform Kushtetutës, dhe ndërprehet bashkëpunimi ynë institucional. Kështu, në gjysmën e korrikut 1995, largohem nga Austria bashkë me Familjen dhe vendosem në Zvicër, si emigrant politik.

Menjëherë pas luftës heroike sublime të Familjës Jashari, në Prekaz, kundër forcave okupuese policore e ushtarake të Serbisë, më 6 mars 1998 përmes kryetarit të Ligës shqiptaro-amerikane Joseph DioGuardit (sipas dakordimit për veprimtari të përbashkët), dergova shkresë për Departamentin e SHBA, dhe në pikën dy (2) të asajë shkrese kërkova: „... SHBA të nderhyjnë me forcat e NATO-s në Kosovë, qe do të kishte efekte të shumfishta: a) ndërprejë luftën e mundshme shqiptaro-serbe; b) krijon mundësi negociatash për zgjidhjen paqësore..., dhe c) shpeton rajonin pa luftë të permasave të gjëra, e cila luftë do

të futë në lojë interesat shekullore të Ruisë për penetrim në Mesdhe". DioGuardi, bashk me ca shqiptaro-amerikan, veptoi urgjentisht, përmes ca kongresistëve deri te presidenti Bil Clinton (shih, librin tim „Kosova 99...“, 124). Po atë ditë (6 mars 1998), me qëllim që të tubohen shqiptar të Diasporës të gatshëm për luftë, në mbrojtje të Kosovës, e inicova formimin e një Qendre Koordinimi me seli në Zürich, nën drejtimin tim (në pajtim edhe te gjithë atyre aktivistëve e ushtarakëve që i takova) për t'i riaktivizuar e fuzionuar të gjitha grupet për luftë në Kosovë. Ideja u mbështet nga veprimtar e oficer të karrierës, kurse Kryetari i Degës së LDK, Gani Sylja, i ofroi në disponim lokalet e Degës. Përmes udhëheqësit të Qendrës Informative-QIK, Enver Malokut (për Fax m'i dergonte Informatat ditore), me të cilin komunikonte bashkëndas i tij-veprimtari Shaban Mulolli, e kerkova dakordimin edhe nga Presidenti Ibrahim Rugova. Sapo ishte degjuar iniciativa ca oficer, të nxitur nga Bujar Bukoshi, vrapojnë nëpër strehimore refugjatesh për të regrutuar shqipëtar (dy grupe tjera të oficerëve ishin ndarë në LPK e LKQK). Kontakti me Rugovën nuk realizohet, dhe, në dakordim me ata veprimtarë e oficer, iniciativa për Qendër koordinimi bie. Unë vazhdoj ta mbështes UÇK-në me miq, luftëtar e logjistikë... Me paraqitjen FARK-ut (fundit i marsit 1998), me, tashmë Koordinatorin e atij formacioni, Kolonel Ahmet Krasniqin (i cili ishte ftuar në Zvicër, nga një miku i Tij, që t'i bashkohej UÇK-së), i pata disa biseda në Zürich, deri disa javë para vrasjes së Tij (Tiranë 21.9.98), dhe insistova që FARK-u t'i bashkohej UÇK-së. Sepse Kosova duhej ta kishte vetëm një Ushtri, UÇK-në! Drejtuesit e UÇK-së me kërkonin ndihmën për bashkim edhe përmes Drejtorisë politike-Adem Demaqit, Shaban Mujës e më vonë edhe Hashim Thaqit. Por, bashkimi në një UÇK u pengue nga ata që e financuan krijimin e FARK, gja që u damtue rëndë Populli dhe Fronti i luftës së UÇK-së, 1998/99, kundër Serbisë (shih, në librin tim „Kosova 99...“, 299-304).

UÇK-së i pata dhanë emrin, luftëtarët e parë i pata shokë të dashtun e bashkëveprimtar, tashmë heronjë të Kosovës, si: Adem Jasharin (që përkushtimin e vendosmerinë time e admironte), Fehmi Lladrovcin-Feja (mik i ngushtë që nga studimet në Zagreb, të cilit i kisha theksuar nderimin Ushtri Çlirimtare-UÇK, që e dinte edhe Ali Ahmeti-Abazi), Bekim Berishën-Abe (Legjionar, e njoha ç'prej ishte nxënës në një bankë me një vëllain tim, në Pejë, vitet e 80-ta, dhe me urdhër timin ishte i vendosur të bënte çdo sakrificë), Sali Çekajn (me të vetmin që i bisedoja qeshtjet e mbrojtjes dhe e takoja, në Zyrët e LDK-së, në Stuttgart), Agim Ramadanin-Katana (e thirrja 'Qosja', me të cilin e kam bisedën e fundit në prag të Vitit Ri 1998 në Zürich, kishte ardh nga fronti i luftës në vizitë Familjës), Agim Qelen (i cili, më leje e udhëzime nga Unë, kohë të gjatë, para se të shperthej lufta në Kosovë, vepronte në Maqedoninë Veriore, konform Strategjisë për Mbrojtje të Trojeve Shqiptare...), e shumë të tjerë. Nuk u ndala se vepruari deri në Shpalljen, për të dytën herë, me 17 shkurt 2008, të Shtetit të pavarur të Kosovës dhe pranimin nga shtetet mike me të fuqishme ushtarake e ekonomike në Planet!

6. Regjimi pushtues i Serbisë në krye me Slobodan Millosheviqin, e kishte derguar kriminelin Zhelko Razhnatoviq-Arkan të bënte atentat ndaj meje-

N.Gjeloshi, në Perëndim, vitin 1993. Edhe në Kosovë në vitin 1994, Ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, M.M., i shperngulur vitet e 80-ta nga Kosova, e ndalon një mikun tim në një fshat të Klinës, dhe e pyet: „Kemi informata se Ministri i juaj i Mbrojtjes, i të ashtuquajturës Republika e Kosovës, Nikë Gjeloshi, ka hyrë në Kosovë për ta nisë luftën; Ti kë qenë në Normale të Pejës me Te, dua të na tregosh kah gjënde?“ Mbase miku im i pergjigjet se „Nuk ka njoftë njeri me emer të tillë..“, Ministri serb e ban me dije se „... do ta gjejmë..!“ (njohtim i mikut N.N., me 2 mars 2021).

Në qërshor të vitit 1995, Gjykata Supreme Ushtarake Federative e Jugosllavisë me dënon në mungesë mue „Nikë Gjeloshin për vepër penale kunder Shtetit e Popullit të Jugosllavisë dhe organizimin e kryengritjës si Ministër i Mbrojtjes në të ashtuquajturën Republika e Kosovës..., nga rezulton se ai nga ajo pozitë në botën e jashtme e ka organizue atë Ministri me oficer të ish APJ të nacionalitetit shqipëtar, e nacionaliteteve tjera, qëllimi kryesor ka qenë të luftojë kunder Shtetit dhe Popujve të Jugosllavisë.“ Më tutje thuhet se: „Ne bazë të nenit... dhe fjalës perfundimtare të prokurorit publik ushtarak ..., per Ministrin e Mbrojtjes të ashtuquajturës Republika e Kosovës, mungon në seancë, i cili gjëndet në arrati në botën e jashtme, Gjykata Supreme Ushtarake e Jugosllavisë bie Vendim dhe e gjykon njëzërit të akuzuarin Nikë Gjeloshi me 10 vjet burg të rëndë, për shkak të veprimtarisë se tij kunder Popullit dhe Shtetit dhe organizimin e Ministrisë se Mbrojtjes të ashtuquajturës Republika e Kosovës e Ibrahim Rugovës...I konfiskohet e gjith pasuria ..“. Nënshkrues i atij Vëndimi: kryetari i Gjykatës, Prof.Dr.Aleksandër Rankoviq, nip i Aleksander Rankoviqit famëkeq për shqiptarët, nder ta edhe për prindin tim gjatë Aksionit të grumbullimit të armëve 1956/57. Për atë denim timin njohtohem në Zvicër nga veprimtari Sadik Jasharaj (Medvegjë) i burgosur politik, themelues i UÇPMB e perfaqësues i Këshillit politik në vitin 2000, të cilin më parë e kishte njohtue avokati i tij malazez, i viteve të burgut. Shih, Aktgjykimi: Rešenje, Vojni Vrhovni Sud Federativne Savezne Republike Jugoslavije, II Sud Br.18816, Beograd 18.Jun 1995; i marrë në Arkivin Shtetror të Republikës së Serbisë përmes një Studio Avokatie në Prishtinë, në vitin 2020.:

VOJNI VRHOVNI SUD
II-Sud Br.18816/95
18. Jun 1995.
Beograd.



U IME NARODA

Vojni Vrhovni Sud Federativne Dvezne Republike Jugoslavije, u ovom krivičnom veću, sastavljenom od sudije: Pukovnika Trifković Momčila kao predsednika veća, sudije Majora Vukosevljevića Vladimira, kapetana I. klase Djordjevića Ljubomira, kao članova veća, i Sekretara Vukomirovića Marijane na sednicu održana na dan 18. Jun 1995. godine do predmet krivice Nika Djeljoši Zbog

krivičnog dela iz člana 3.4.3. zakona, o krivičnim delima protiv naroda i država i Organizovanjem, pobuna, kao Minister Odbrane u takozvanoj Republika Kosovo iz toga pozicija on u inostranstva organizovao tu Ministarstvo sa bivšim JNA Albanske nacionalnosti, i drugih nacionalnosti, gdeje glavni cil bio ratovati protiv Države i Narodina Jugoslavije.
Na osnovu člana 36. zakona o organizaciji Narodnih Sudova i zadnjem r. vojnog Javnog Tužioca, Putovnika Stojanovića Vlastimira, koji zatražio 15. godine strog zatvor za ministre odbrane takozvane Republika Kosova odsutni u sednicu, koji se nalazi u begstvo u Inostranstvo Vrhovni Vojni Sud Jugoslavije doneo Sledeću:

REŠENJE

Vojni Vrhovni Sud donese odluku jednoglasno Osudio Optuženog Nika Djeljoši na 10. (Deset). godine strog zatvor, zbog njihovog delovanje protiv Naroda i Države Organizujući Ministarstvo Odbrane takozvane Republika Kosovo Ibrahima Rugova.

OBZLŽENJE:


Veće Vrhovnog II. Vojnog Suda u Beogradu Uzejući u obzir sve okolnosti i da Osudjenik nalazi u Inostranstvo i operuje svoj delatnost, dolazio do to Rešenje, kao napisano u napred Osudjuje na 10 (deset) godina strogo zatvor, i konfiskacije celokupne imovine i trajna gubitak Političkih i građanskih prava.

Pravom letu na ovaj rešenje stranka u roku od dana prijem Predsedništvo skupštine Federativne save Republika Jugoslavije.

Minister Suda u Beogradu 18. Juna 1995.

Vukomirović Marijane

Vukomirović Marijane



Predsednik Suda
I. Dr. Rantović Aleksan

Rantović Aleksan

7. Për historinë politike të asaj periudhe, për herë të parë publikisht do ta theksoj edhe faktin se, dy tri ditë pa iu komunikuar posti kryetar i Qeverisë, Bujar Bukoshit, është Nikë Gjeloši që kishte biseduar me Ibrahim Rugovën për postin e kryetarit të Qeverisë. Rugova i kishte thanë Gjeloshit: „...Nuk kam kënd ta dërgojë jashtë për kryetar qeverie“. Në pyetjen se asnjë njeri nga LDK nuk e ke (mbase LDK si subjekti më i madh politik, sipas bindjës së Gjeloshit, ishte e drejtë ta jepte kryeqeveritarin), Rugova përgjigjet „nuk kam, vetëm nëse e qes Bujarin, sekretarin e LDK-së“. Gjeloši i thotë Rugovës: „Qite, Unë jam me Te...“. Dhe ashtu veprohet! Edhe se nuk e njihte mirë Bukoshin, Gjeloši i theksonte

idetë, dhe bënte veprime praktike politike, si mision, me të vetmin qëllim që proceset politike t'i çonte drejt idealit për liri e pavarësi!
Këtë fakt të ëmrrimit, në një drekë në Stuttgart (1992, pas zgjedhjeve parlamentare e presidenciale), në prezencën e tre qeveritarve tjerë, ia kam thanë Bukoshit se: „Unë të kam ba kryetar qeverie ..“. Edhe nga Selia e Vatikanit, që isha për ta dorëzuar kërkesën zyrtare për pranimin e shtetit të Kosovës nga shteti i Vatikanit (1992), Unë-N.Gjeloshi po atë ditë Bukoshit, që ishte në Bruksel, i sigurova takime me mbi 10 përfaqësues shtetesh. Dhe falenderimi i Bukoshit ishte: „Askush nuk folke me mue, veç kurë kam degjue se nunci i Vatikanit po e kërkon kryeministrin Bukoshi“.
Disa herë jamë kthyer nga jashtë për ta ndihmë ndertimin e Shtetit të Kosovës, por, perkunder dakordimeve me faktor politik të kohës, nuk zbatohesh fjalat e dhënë. Më 31 tetor 2012 e takoj Bukoshin para Pallatit të Qeverisë, tani ishte zv/kryeministër, i cili me fton ta vizitoj në zyrën e tij. Në bisedën e gjatë për të kaluarën, dhe për ato aktuale, Bukoshi me thot: „Ti, Nikë, ke qenë i perkushtuem me ba Shtetin... Këtu, edhe sot veprojnë shërbime të shumta, nuk të lanë as në politikë...!“ Mbase ato shërbime të shumta a mos e detyruan Bujarin që, përmes një publikimi „Republika e Parë“, të thekson të pavërtetën notore dhe t'ia heshtë apo t'jëterson Nikës veprimtarinë e funksionet në Qeverinë e exilit? Në fakt e verteta sado që heshtet nuk mundë të t'jëtersonhet e as të zhbëhet, sepse gjurmët e veprimtarisë politike zbulohen herët o vonë si ato arkeologjike! Edhe me atë rast, Unë ia kam rikujtuar se pas bisedës që ka patur më mue „Rugova ia ka komunikuar postin e kryetarit të qeverisë dhe pastaj ai, Bukoshi, ka dalë jashtë“, e pohuar edhe në publikimin e theksuar, se: „Rugova më 12 tetor (1991, N.Gj.) e thirri Bukoshin në zyrë dhe ia komunikoi vendimin...“. („Republika e parë“, 160).

8. Në atë publikim „Republika e Parë...“, edhe së i dedikohet Bukoshit, nuk shifet të jetë publikuar një intervistë e tij „Kosova nuk ka me as president e as qeveri“ dhënë javorës „Zëri Shqiptar“, në gjysmën e vitit 1997.

Në atë intervistë, ndër tjera, Bukoshi e kishte pranuar se: „... Tashmë dihet se, që dy-tri vjet edhe permbajtësisht edhe nga aspekti formalo-juridik, janë krijuar vakume të mëdha në funksionimin e institucioneve tona... Në Kosovë që nga 24 maji (1992, N.Gj) nuk është marrë asnjë vendim... Pas 24 majit (1992, N.Gj.), as Presidenti i Republikës nuk është legjitim, as Qeveria nuk është legjitime, ka një hendek të madh midis synimeve të popullit të Kosovës për pavarësi dhe mosangazhimit..., apo ndoshta edhe angazhimit..., për të zhbërë atë për të cilën u deklaruem... Tash është tepër vonë që të themi se nuk patëm përgjegjësi për këtë që bëmë, përkatësisht për atë që nuk bëmë“. Shih, „Zëri Shqiptar“, nr.5-6, Viti 53, 22 qershor 1997, 13,14,15; nenvizimet me stilolaps janë të miat, N.Gj.:

DR. BUJAR BUKOSHI, KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS


KOSOVA NUK KA MË AS PRESIDENT E AS QEVERI

Ibrahim Rugova, me disa servilë përreth tij. Nuk është gabim shtypi: Ibrahim Rugova me disa servilë përreth tij ka refuzuar dhe refuzon ta institucionalizojë Kosovën. - Sjellja e papërgjegjshme e Rugovës është shprehje e degjenerimit të politikës sonë për pavarësi. - Serbisë i konvenon ky status quo, bashkësia ndërkombëtare nuk do të lashtë. - Nuk ka gati asgjë nga lëvizja popullore për dirim në LDK-në e sotili. - Nuk kam bërë përfitime materiale apo abuzime financiare për fitim personal. - Nëshkrimi i marrëveshjes për arsimin nuk është bërë për t'u realizuar. - Shtyerja e zgjedhjeve është mohim i gjithë asaj që kemi thënë deri tash. - Populli duhet të kërkojë llogari nga prijësit e deritashëm. - Mendoj se UÇK-ja ekziston. QIK-u bën punën e djallit

PSE PO FLAS KËSHTU

Ju falënderoj për intervistën në këtë rubrikë. Po ashtu i falënderoj lexuesit në pyetjet e dërguara. I vetëdijshëm se paraqitja e këtyllë linja mund të shkaktojë polemika të tjera, analiza, vlerësime të disallojshme, dëshiroj të bëj disa sqarime. Ka shumë argumente me të cilat mund të kritikohet politika aktuale e Kosovës, natyrisht këtu nuk është e mundur të numërohen të gjithat. Më mirë do të ishte që gjërat që dalin këtu, në këtë javore, në këtë rubrikë, me këtë stil, të dilnin më parë para një parlamenti ose para institucioneve të tjera përkatëse, të shtriheshin në shtyrtime. Në atë rast, shumë gjëra do të merrnin kahje tjetër dhe, po ashtu, shumë fenomene të shëmtuara do të parandaloheshin. Unë e ndjeva veten të detyruar që të prezantohem edhe në këtë mënyrë, mënyrë për mua dhe për të gjithë të tjerët aspak e pëlqyeshme, me përjashtim të Ibrahim Rugovës, i cili edhe me këtë rast, është kjo bindja ime, nuk do ta çajë kokën. Ka ardhur puna që politika jonë të lansohet vetëm në konferenca të shtypit, ministrat të japin ekspertiza nëpër fletushka gjysëm-partiake se a është ky apo ai veprim i drejtë apo nuk është etj. Politika bëhet në çajitore e pijetore, në oda, dasma e vdekje, në gazeta pornografike e gjysëm-pornografike, por jo në institucionet e duhura. Kjo flet shumë për ne dhe shtron përgjegjësinë edhe të subjekteve të tjera politike. Insistimet tim për t'i sqaruar gjërat, Rugova i është përgjigjur me nonshalancë dhe me mungesën e tij të zakonshme të kurajos për t'i parë gjërat realisht. Unë, si kryetar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, jam munduar të kontaktoj edhe me disa parti politike dhe, me koqardhje, kjo është e vetmja

mënyrë për të shtyrë njerëzit tanë të kërkojnë sqarim për politikën tonë dhe sqarim nga udhëheqja e Kosovës. Tani ka një hendek të madh në mes meje, Bujar Bukoshit dhe atij, Ibrahim Rugovës, për të cilin më unë nuk e di se çfarë synon. Ka një hendek të madh midis symmeve të popullit të Kosovës për pavarësi dhe mosangazhimit të tij apo ndoshta edhe angazhimit të tij për të zhbërë atë për të cilën u deklarua. Tërë ky dobësim i lëvizjes sonë për pavarësi ndodh në kurriz të një besimi që kanë pasur njerëzit, besim të cilin ne e kemi shpenzuar pa e kuptuar ndoshta as vetë se çka po bëjmë. Dëshiroj edhe një herë t'i përkujtoj lexuesit dhe opinionin tonë se Qeveria e Republikës së Kosovës është zgjedhur si qeveri e përkohshme me një mandat kohor të përcaktuar dhe me një mandat politik të pandryshuar: atë të referendumit për realizimin e pavarësisë së Kosovës. Deri në këtë maj, mandati kohor i qeverisë është varur nga mandati i parlamentit të Republikës së Kosovës, i cili nga pikëpamja teknike ka skaduar me kohë, qëkurse ai nuk arriti të mbledhë dhe të merrte vendime përkatëse në seanca plenare, që janë edhe forma e vetme e vendim-marrjes. Funkcionimi i disa grupeve parlamentare, siç thuhet, është vërtetë një mirazh i funksionimit të demokracisë, por kurrsesi nuk mund të interpretohet si realizim i mandatit të zgjedhësve. Kështu fillon farsa dhe tragi-komika e një vendi të okupuar dhe një populli të dhunuar. E, në Kosovë, që nga 24 maji 1992, nuk është marrë asnjë vendim. Në pikëpamje politike vendimet e marra nuk janë ratifikuar, e për më tepër dihet që këto vendime nuk e kanë avancuar pavarësinë. Mjafton të përmendet se



gjatë kësaj periudhe të ashtuquajtur të realizimit të pavarësisë e të mbështetjes ndërkombëtare për të, janë bërë deklarata të njëpasnjëshme të diplomatëve perëndimorë, përfshirë SHBA, të cilët kanë ritheksuar qëndrimet e tyre për zgjidhjen e çështjes së Kosovës brenda Serbisë. Pra, mandati politik që populli u ka dhënë përfaqësuesve të tij, kështu nuk po realizohet. Ndërkohë, edhe koha e vënë në dispozicion të politikaneve për të vepruar konkretisht për realizimin e pavarësisë për këtë grup politikësh kaloi. Edhe pse po bëhet shumë akrobatikë me argumentimin se në Kosovë është gjendje e jashtëzakonshme, nga ana tjetër po ashtu mund të interpretohet se për këtë gjendje të jashtëzakonshme nuk është nxjerrë ndonjë vendim, se parlamenti që e nxjerr nuk është mbledhur; se kjo gjendje në Kosovë ekziston de facto vite me radhë dhe brenda kësaj gjendjeje ne i mbajtmë zgjedhjet e vitit 1992. Në fundi, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, veprimtaria e partive politike kufizohet dhe merr një prioritet të veçantë të përkohshëm, të cilin nuk e vërejmë në Kosovë. Sidoqoftë, Qeveria është organi ekzekutiv i orientimeve politike të Kosovës.

NË EMËR TË POPULLIT

Bexhet HALIMI, Zvicër:

Sa ka ndikuar gjendja aktuale në Shqipëri në humbjen e besimit të shqiptarëve të Kosovës për pavarësinë e Kosovës?

BUKOSHI: Nuk ka ndikuar as qsa ka ndikuar shkapërdërdhja e vullnetit politik të popullit tonë nga politika e udhëhequr në Prishtinë. Këtu ka ndikuar keq propaganda e kreteneve tanë politike, të cilët i fërkonin çfarë që tani Kosova po del më e matur, më e mençur, më e civilizuar e të tjera marina. Pra, njëfarë konkurrence idiotike! Një mentalitet tipik rezidual jugosllav që karakterizohet me mburrje pa mbulesë dhe me arrogancë. Aparatet tanë partiakë filluan të flasin jerëm se Shqipëria nuk mund të mbaje shtet, por Kosova mundet, se ajo paska dhënë edhe prova gjatë këtyre viteve! Trup shqiptari e kokë sllavi! Shqipëria do të rrekuperohet dhe do ta marrë veten. Shqipëria është shtet. Shqipëria ka resurse të forta intelektuale. Nëse eliminohen ekskluzivitetet politike në Shqipëri, ajo do ta marrë shpejt veten. Keni mundur të shihni fytyra shend e verë tek disa mjëra në Kosovë që i gëzoheshin kaosit në Shqipëri, se kështu feudi shqiptar i copëtuar në Kosovë gjidja tani po del më i zoti dhe gjoja po fituaka identitetin ndërkombëtar! Mistrecët vetëm me dromca ngopen!

Afrim SADRÏU, Zvicër:


Politika e Kosovës që udhëhiqet nga Rugova, Bukoshi dhe nga partitë politike të Kosovës deri më tash nuk ka ndërmarrë asgjë për ngritjen e shtetit të Kosovës, pos konferencave për shtyp dhe telegrameve me urime politike. A nuk është koha e përgjegjësisë për këtë klasë udhëheqëse?

BUKOSHI: Unë pikërisht këtë po e them: është koha e përgjegjësisë maksimale. Ka kohë që nevojitet një gjë e tillë - institucioni i llogari-dhënies.

Nehat MUSTAEFA, Zvicër:

Pas shumë deklaratave Tuaja, presidenti Rugova deklaroi se ato janë qëndrime personale. Çka i thoni Ju kësaj pune?

BUKOSHI: Kësaj pune unë i them përpjekje për mosballafaqim me realitetin. Deklaratat e mia nuk kanë si të jenë qëndrime personale, dhe unë, ndryshe nga Rugova, nuk kam një qëndrim personal dhe një qëndrim shtetëror. Në krye të kësaj pune unë isha kryeministri i Kosovës. Z. Rugova as sot nuk ka kursjo të thotë publikisht pse nuk pajtohet me Bukoshin, sepse në rend të parë, nuk ka guxim të pranojë se ka një Qeveri të Republikës së Kosovës, për formimin e së cilës edhe vetë e ka dhënë miratimin. Bile, edhe Republika e Kosovës e institucionalizuar për atë është bërë një fantazmë



Gjërat janë me kokë teposhtë.

e frikshme, të cilës ai përton t'ia përmend emrin. Të kesh Qeveri, të kesh Parlament, të kesh opinionon të fortë dhe kritik, të kesh institucionet e tjera që nuk të lejojnë të bësh çka të duash, është telashe. Më mirë e shumë më komode është të aktrosh shtet se sa ta krijosh atë, ose ta mbrosh atë, ose ta forcosh atë. Thuhet se kryetari Clinton ka pasur telashe pse njëherë paska porositur berberin që të një në aeroportin e tij për ta nënqethur. Kjo nënqethje paska kushtuar shtrenjt - disa qindra dollarë dhe kështu u kërkua sqarim për këtë punë.

PAS 24 MAJIT NUK JANË LEGJITIMË AS PRESIDENTI, AS QEVERIA

Sabit GECAL, Zvicër:

Në deklaratën e fundit Ju sikur dëshironi t'i ikni përgjegjësisë, duke ia lënë këmbët, e arushës dikuj tjetër. Pse kështu?
- Çfarë mendoni për vrasjen e kolaboracionistëve shqiptarë?

BUKOSHI: - Nuk mund t'i ikë kësaj përgjegjësie, është punë që nuk bëhet. Tashmë dihet se, që dytri vjet, edhe përmbajtësisht edhe nga aspekti formal-juridik, janë krijuar vakume të mëdha në funksionimin e institucioneve tona. Asgjë nuk qëndron në vendin e vet. Gjërat janë me kokë teposhtë. Mendoj se pas 24 majit as presidenti i republikës nuk është legjitim, as qeveria nuk është legjitime edhe pse ka përpjekje që, me shtytjen e zgjedhjeve dhe me ekzibicione të tjera të përtigjen

veprimet e paligjshme dhe të papërgjegjshme. Dihet se kjo punë nuk shkon kështu. Mirëpo as kjo nuk ka shumë rëndësi sa ka rëndësi fakti se në udhëheqjen e Rugovës shqiptarët e Kosovës kanë arritur në një qorrsokak, nga i cili momentalisht nuk po dinë si të dalin. Tash është tepër vonë që të themi se nuk patëm përgjegjësi për këtë që bëme, përkatësisht për atë që nuk bëme.
- Mendoj se problemi nuk qëndron të kolaboracionistët por qëndron te ata që po përtigjen për të vrrarë nocionin e pavarësisë.

Mustafë GASHI, Zvicër:

Sa herë që Ju deklaroni diçka, Rugova thotë se ato janë qëndrime personale, apo si tash së fundi kur thotë se Bukoshi e ka tepruar.
A e ka tepruar ndonjëherë Rugova dhe pse Ju nuk ia thoni këtë?

BUKOSHI: Mendoj se Rugova e ka tepruar dhe s'është përparim por nuk është fajtor vetëm ai. Thonë se është karakteristike e politikanëve të dështuar ose e politikanëve që gjenden para dështimit shurdhmi dhe verbërimi i qëllimshëm. Ka shumë pyetje, në të cilat jo vetëm qeveria, por edhe çdo qytetar i zakonshëm i Kosovës ka të drejtë të kërkojë sqarime. Duhet ditur se për cilat qëllime angazhohemi aktualisht. Këtu unë nuk i llogaris parullat dhe sloganet manipuluese. Ndoshta Rugova ka menduar se unë, për shkak të një subordinimi të mjerë, nuk do të kërkoj shpjegime për gjërat që kanë të bëjnë me angazhimet tona themelore dhe se do të respektoj me përlutësi çdo politikantizëm banal të dishepujeve të autonomisë kulturore, për të cilën faktikisht ka filluar të angazhohet edhe ai vetë.

Sylë RUGOVA:

- Ju thoni se jeni për pavarësinë e Kosovës, atëherë pse e përkrahni Ballkaninë e Demaçit kur dihet se ajo është kundër pavarësisë së Kosovës?
- Ju po thimi në rezistencë aktive. Pse nuk po ktheheni në Kosovë për t'i mbledhur shqiptarët dhe atje të rezistoni?

BUKOSHI: - Nuk jam ihtar i Ballkanisë dhe nuk e kam përkrahur atë.
- Shqiptarët duhet ta shkundojnë plogëshitinë e tyre. Unë do të gjendem aty ku do të gjenden edhe të gjithë shqiptarët.

Merita BAJGORA, Zvicër:

Në deklaratën Tuaj të fundit thoni se nuk dëshironi të merrni pjesë në hipokrizinë kundër popullit shqiptar. A do të thotë kjo se dëshironi të jepni dorëheqje?

BUKOSHI: Është krijuar një situatë paradoksale. Para kujt të jap dorëheqje? Para atyre që kanë hequr dorë nga pavarësia e Kosovës?

Pas pesë (5) vitesh të të qenunit i jashtëligjshëm e jo funksional, Bukoshi, tashmë e kishte pranuar se „.... as Qeveria nuk është legjitime“, se „ ... , ka një hendek të madh midis synimeve të popullit të Kosovës për pavarësi dhe mosangazhimin..., apo ndoshta edhe angazhimin..., për të zhbërë atë për të cilën u deklaruem“ (po aty, 13); por duhej ta pranonte edhe faktin se në atë „Qeveri“ jolegjitime e jofunksionale, e cila ishte degradue në tërësi, kishte mbetë vetëm më një minister-arkatar, Isa Mustafën, në atë Publikim njëri nga konsulentet. Po ate minister-arkatar, me kërkesën e Sali Çekajt, Unë-Nikë Gjëlloshi i shpetova kokën

në shkurt 1992, pasi bisedova me tre (3) bashkëkombas që çdo të shtunë, në koridorin e Zyrëve të LDK (në Stuttgart), po e prisnin atë minister ta takonin që t'i hakmerren sepse pas demonstratave të vitit 1981 i kishte diferencuar nga puna dhe detyrohen të emigrojnë (ministrave tjerë nuk u kishte ecë fjala për t'ia shpetue koken atij ministri!). Më parë Zyra e LDK-së ishte bërë me dije nga organet kompetente gjermane, se „po ndodhi ndonjë konflikt, do u mbyllim zyret dhe do u ndalojmë veprimtarinë!“

Poashtu, rezulton se Gjeloshi nga mbajtja e zgjedhjeve të 24 majit 1992 kishte të drejtë që vazhdimisht insistonte në legjitimitetin e institucioneve, përkatësisht konstituimin e Parlamentit e zgjedhjen/emërimin e Qeverisë së re. Konstituimi i Parlamentit dhe zgjedhja apo emërimi i qeverisë së re, ishin:

-obligim kushtetues, e duhej zbatuar Kushtetuta.

-atë e kërkonte edhe udhëheqja e ngushtë e LDK me Fehmi Aganin, për çfar në vitin 1994 ndodhin thyrjet në LDK.

-atë e kërkonin edhe miqtë tanë që na mbështetnin në kauzën tonë për pavarësi.

Per autorin e këtij Reagimi, ishte e qartë se lanja anash e rregullave kushtetuese historikisht ka qenë rrezik, për çfar tërhiqte vërejtjen, për Republikën Romake, edhe M.T.Ciceroni 60 vjet para Krishtit!

9.Ashtu si Niccolo Machiavelli (Sundimtari,1513), Tomas Moor (Utopia,1516), Jan Jack Russo (Kontrata shoqërore,1762) e Charles de Gaulle (pas luftës Dytë Botërore), që si protagonist të krijimit të shteteve të tyre bënë kritika të ashpra ndaj rregullit të ndertuar keq; Unë, si protagonist i ndertimit të Shtetit të Kosovës, edhe se pata pasoja në karrieren time politike, nuk kam hezitur për ta kritikuar rregullin e ndertuar keq në Shtetin tim, Republikën e Kosovës. Rregulli i ndertuar keq, i ka krijuar hapësirë veprimi Serbisë që, përmes segmenteve politike, ekonomike e të sigurisë ta forcojë ndikimin dhe ta degradojë Shtetin e Kosovës. Degradimi i Shtetit të Kosovës vazhdon të bëhet nga kastat pushtetare shqipëtare të tipit të kakistokracisë; kasta neofashiste e neobolshevike të cilat populli shqiptarë duhet lanë anash sa më parë.

Kosova është bërë!

Kosova, si pjesë e gjeopolitikës Perëndimore, e prirë nga idealistët duhet të rrugëtojë drejtë Unifikimit Kombëtar ashtuqë baraspesha e popujve dhe territoreve ta garantojë stabilitetin dhe sigurinë e kësaj pjese të Evropës.

Për fund,

Hartuesi e porositi i publikimit „Republika e Parë-historia politike e Kosovës 1989-1999“, UETPress,Tiranë, kanë obligim t'i kërkojnë ndjesë publike autorit të këtij Reagimi dhe ta bëjnë përmirësimin e atyre të pavërtetave në atë publikim. Ndryshe, hartuesi e porositi i atij publikimi do të procesuohen dhe historia politike e asaj periudhe të shkruhet ashtu siç është në të vërtetë!

Prishtinë, 2024